

Spektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 12.07.2022, në përputhje me nenin 28 dhe nenin 32 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi këtë:

## **M E N D I M   J U R I D I K**

Nuk ka arsye të rëndësishme për caktimin e gjyqit tjetër kompetent real, nëse pala, përfaqësuesi ligjor ose autorizuesi i palës është familjar nga gjaku në linjë të drejtë të kryetarit të gjyqit.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vepruar për lëndën konkrete të formuar me propozim për caktimin e gjyqit tjetër kompetent real, erdhi në përfundim se për të siguruar zbatimin unik të ligjit duhet që Spektori i veprave civile të gjykatës të shqyrtojë për këtë çështje juridike, nëse ekziston arsye me rëndësi për caktimin e gjyqit tjetër kompetent real, nëse pala, përfaqësuesi ligjor ose autorizuesi i palës është familjar nga gjaku në linjë të drejtë të kryetarit të gjykatës.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur për çështjen juridike të parashtruar, e zbatoi dispozitën e nenit 61 të Ligjit për procedurë kontestimore dhe nenin 6 paragrafi (1) nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas nenit 61 të Ligjit për procedurë kontestimore ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.79/2005...124/2015), Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozimin e palës ose nga gjyqi kompetent, mund të caktojë për lëndën e veçantë të veprave gjyq tjetër kompetent real, nëse duket se kështu më lehtë do të zbatohet procedura ose nëse për këtë ekzistojnë arsye të tjera me rëndësi.

Arsye e vetme për shkak të së cilës është parashtruar propozimi, është që të largohet dyshimi në objektivitetin dhe paanshmërinë gjatë vendimmarrjes së gjyqtarëve të asaj gjykate, por duke marrë parasysh faktin se në lëndë konkrete, pala, përfaqësuesi ligjor ose autorizuesi i palës është familjar nga gjaku në linjë të drejtë të kryetarit të gjykatës. Duke i marrë parasysh dispozitat kushtetuese dhe ligjore, sipas të cilave gjyqtari në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit është autonom dhe i pavarur, kurse të drejtën e zbaton paanshëm, sipas Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, rrethana e kështu vet në vete nuk paraqet arsye relevante dhe bazë për caktimin e gjyqit tjetër kompetent real dhe bazë për zbatimin e nenit 61 të Ligjit për procedurë kontestimore.

Sipas nenit 6 paragrafi (1) nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çdo person gjatë përcaktimit të të drejtave civile dhe detyrimet e tij ose kur është i ndjekur penalisht, ka të drejtë për gjykim korrekt dhe të paanshëm.

Propozimi për caktimin e gjyqit tjetër kompetent real në procedurë, është i pabazë dhe i paqëndrueshëm edhe nga këndvështrimi i opinionit dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Konstatimi i përgjithshëm, i përgjithësuar i ekzistencës së justifikuar në paanshmërinë në veprimin e të gjithë gjyqtarëve të një gjykate, për faktin se pala, përfaqësuesi ligjor ose

autorizuesi i palës është familjar nga gjaku në linjë të drejtë të kryetarit të gjykatës, sipas Gjykatës Supreme të RMV, nuk është konkretizuar mjaftueshëm. Para se gjithash, lëndët e formuara të reja në gjykatë, sipas Ligjit për gjykatat dhe Rregullores gjyqësore, shpërndahen përmes sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore, që do të thotë se kryetari i gjykatës nuk mund të ndikojë në zgjedhjen e gjyqtarit që do të veprojë me lëndën konkrete. Pastaj në rastin kur kryetari i gjykatës nuk vepron për lëndën konkrete, por është familjar nga gjaku në linjë të drejtë me palën, përkatësisht autorizuesin e palës në lëndë, vlerësohet shkalla e ndikimit dhe presionit që kryetari i gjykatës mund ta bëjë ndaj gjyqtarit që vendos për lëndën. Sipas nenit 88 të Ligjit për gjykatat, që i rregullon kompetencat e kryetarit të gjykatës, i njëjti e përfaqëson gjykatën, e organizon punën, ndërmerr masa për kryerjen në rregull dhe në kohë të punëve në gjykatë dhe e siguron zbatimin e Rregullores gjyqësore, prej nga mund të arrihet në përfundim se nuk ekziston qëndrim hierarkik të kryetarit të gjykatës lidhur me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga ana e gjyqtarëve. Në mungesë të ndonjë veprimi të kryer nga kryetari i gjykatës që do të mund të konsiderohet se ndikon te gjyqtarët, lidhja e kryetarit të gjykatës me ndonjë nga palët në lëndën ose autorizuesin e tyre, nuk është e mjaftueshme për të shkaktuar frikë objektive të arsyetuar në lidhje me paanshmërinë e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës kompetente, një kërcënim ose rrezik i menjëhershëm që do të çonte në padrejtësinë e procedurës në fjalë, kështu që nuk mund të konsiderohet i justifikuar objektivisht në kuptim të nenit 6 paragrafi (1) nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila domosdo duhet të rezultojë në heqjen e plotë të frikës së tillë ose rrezikut përmes caktimit të një gjykate krejtësisht tjetër kompetente reale.

Nga e ekspozuara më sipër, vijonte që të miratohet mendimi juridik.

**Gjykata Supreme e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Sektori i veprave civile**